



RAPORT I KOMISIONIT VLERËSUES PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM

Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore

Lëndët/Pozitat: 13. Ekologji e ekosistemeve (Biologji Msc. Sems. I; 2+2; O), Biologjia e konservimit (Ekologji Msc. Sems. II; 2+2; O), Fauna e Kosovës (Biologji MSc. Sems. III; 2+2; Z), Biologjia e llojeve invasive (Biologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Principet e akuakulturës (Biologji MSc. Sems. III; 2+2; Z), Ekologjia e sjelljes së kafshëve (Ekologji Bsc. Sems. III; 2+1; Z), Zooindikatorët (Ekologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Planifikimi hapësinor dhe mjeti (Ekologji Bsc. Sems. VI; 2+1; O)

Komisioni vierësues (prej 5 ose 3 anëtarave):

1. **Kryetar** Prof. Dr. Linda Grapci-Kotori
2. **Anëtar** Prof. Dr. Halil Ibrahim
3. **Anëtar** Prof. Dr. Agim Gashi

Kandidatët e paraqitur sipas pozitave liendëve të shpallura me thirrjen publike (numrat rendor shtohen ose fshihen sipas nevojës dhe varësishët nga numri i pozitave apo kandidatëve):

1. Astrit Bilalli
2. Djellza Panxhaj
3. Avdyl Bajrami
4. Besnik Dakaj
5. Mirlinda Dehari-Zeka

UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE
PRISHTINA

Ditën e më: 29.08.2024		
Ni. org.	Numer	Sasia
01	2975	7
		—



RAPORTI PËRMBLEDHËS I KOMISIONIT VLERËSUES

Në konkursin e shpallur për angazhim të bashkëpunënëtorëve të jashtëm për ligjëratë dhe ushtrime nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore për pozitën 13 (Departamenti i Biologjisë pozita 3): Një bashkëpunëtor për ushtrime, përlendet: Ekologji e ekosistemeve (Biologji MSc. Sems. I; 2+2; O), Biologja e konservimit (Ekologji Msc. Sems. II; 2+2; O), Fauna e Kosovës (Biologji MSc. Sems. III; 2+2; Z), Biologja e llojeve invazive (Biologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Principejt e akuakulturës (Biologji MSc. Sems. III; 2+2; Z), Ekologjia e sjelljes së kafshëve (Ekologji Bsc. Sems. III; 2+1; Z). Zooindikatorët (Ekologji Msc. Sems. III; 2+2; Z), Planifikimi hapësinor dhe mjedisë (Ekologji Bsc. Sems. VI; 2+1; O) kanë aplikuar 5 kandidatë: Astrit Bilalli, Djelizza Panxhaj, Avdyl Bajrami, Besnik Dakaj dhe Mirlinda Dehari-Zeka.

Kandidati **Astrit Bilalli** ka të përfunduar doktoratën dhe nivelet tjera të studimeve në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Shkencave Matematiko Natyrore – Departamenti i Biologjisë (nota mesatare bachelor 9.42, nota mesatare master 9.88, nota mesatare doktoratë 9.05). Qe nga viti 2015 është staf i irregullit në Universitetin Haxhi Zeka, Fakulteti i Agrobiznesit dhe mban thirrje akademike profesor asistent. Në vitin akademik 2015/2016 ky kandidat ka qene i angazhuar në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ndërsa nga viti 2016 - 2024 është angazhuar si bashkëpunëtor i jashtëm në Fakulteti i Shkencave Matematiko Natyrore – Departamenti i Biologjisë. Kandidati është autor i parë apo autor korrespondent në 22 punimi të botuar në revista me recension ndërkombëtar, po ashtu është koautor në disa punimeve tjera të indeksuara në data baza prestigjioze (Web of Science, Scopus etj). Kandidati Astrit Bilalli gjithashtu ka marrë pjesë në konferanca shkencore ndërkombëtare si dhe në trajnime dhe projekte të ndryshme. Kandidati **Djelizza Panxhaj** ka të përfunduar studimet themelore (nota mesatare 8.63) dhe master (nota mesatare 9.82) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë. Është autore në një punim shkencor dhe ka prezantuar një abstrakt në një konference vendore. Kandidatja në fjalë në vitin akademik 2023/24 ka qenë e angazhuar si bashkëpunëtore e jashtme në Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka", Fakulteti i Agrobiznesit.

Kandidati **Avdyl Bajrami** ka përfunduar studimet e doktoratës në Universitetin Bujqësor të Tiranës, në fushën "Bujqësi dhe Mjedis" drejtimi "Shkencë Agronomike", studimet master në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë, drejtimi Ekologji mbrojtje e ambientit (nota mesatare 8.13) dhe studimet themelore në drejtimi Biologji-Kimi



UNIVERSITETI I PRISHTINËS



(nota mesatar 7.50) në Universitetin e Prishtinës – Shkolla e lartë pedagogjike në Gjakovë. Kandidati është autor dhe bashkautor në disa punime shkencore dhe pjesëmarrës në konferanca shkencore.

Kandidati **Besnik Dakaj** ka të përfunduar studimet themelore (nota mesatare 9.03) dhe master (nota mesatare 9.41) në Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë. Është bashkautor në një punim shkencor dhe ka ndjekur trajnime rreth kurrikulës dhe mësimdhënies.

Kandidatja **Mirlinda Dehari-Zeka** ka të përfunduar studimet e doktoratës (nota mesatare 8.90), magistraturës (nota mesatare 9.6) dhe studimet themelore (nota mesatare 9.73) në Universitetin e Prishtinës, Fakultetin e Shkencave Matematike Natyrore, Departamenti i Biologjisë. Kandidatja është autore në një punim shkencore dhe pjesëmarries në konferanca shkencore gjithashtu ka ndjekur trajnime në fushën e mësimdhënies.

Komisioni bazuar në irregulloren për procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtoreve të jashtëm në Universitetin e Prishtinës, dhe pas analizimit të dosjes së kandidateve konstaton se kandidati Dr. sc. **Astrit Bilalli** i plotëson kushtet me se miri nga të gjithe kandidatet e paraqitur. Kandidati Astrit Bilalli mban thirjen akademik Profesor Asistent dhe ka përvojë në mësimdhënie në institucionë të arsimit të lartë që nga viti akademik 2014/2015 (në Universitetin e Prishtinës dhe Universitetin 'Haxhi Zeka'). Ai ka përfunduar studimet në të gjitha nivelet me rezultate të shkëlqyera, ka publikuar 22 punime shkencore si autor i parë apo korrespondent në revista shkencore kredibile të indeksuara në WoS dhe Scopus, dhe ka marrë pjesë në konferanca shkencore ndërkombëtare. Duke u bazuar në këto fakte, komisioni i rekandondon Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike Natyrore që kandidati **Astrit Bilalli** të angazhohet si bashkëpunëtor i jashtëm për pozitën e lartëkur.

Komisioni vlerësues:

1. Prof. Dr. Linda Grapci Kotori – Kryetar

2. Prof. Dr. Halil Ibrahimimi – Anëtar

3. Prof. Dr. Agim Gashi – Anëtar
